

PËRSIATJE HISTORIKE E KULTURORE E POLENËS

ROMEO TEROLLI, Universiteti

“Fan S. Noli”, Korçë, romeo_terolli@hotmail.com

ILIRIAN KOROVESHI

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, koroveshiilirian@gmail.com

Abstrakt: Polena është një nga vendbanimet më të hershme në zonën e Korçës, me gjurmë arkeologjike, tradita dhe zakone të hershme.

Qëllimi i këtij punimi është që të identifikojë elementë të historisë, të kulturës, aspekteve ekonomike, fetare, gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak, zakoneve e traditave si dhe elementëve të jetës së përditshme.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është kombimin i studimeve të mëparshme dhe të dhënave të shkruara dhe intervistave të terren të realizuara me banorët e zonës. Teknika e intervistimit në këtë studim shërben si mjet për identifikimin e elementëve që janë në qëllim të studimit.

Përmes të dhënave të grumbulluara nga dokumentat paraprake, intervistat e kryera në mënyrë të drejtëpërdrejtë qartësohet se në historinë e Polenës ka një shumësi ngjarjesh për të cilat duhet të shkruhet dhe hulumtohet më tej, duke u nisur nga parimi që Polena paraqet një vendbanim të hershëm e të dëshmuar përmes gjetjeve arkeologjike në të dhe rreth saj. Polena nga ana tjetër paraqet një komunitet me vlera kulturore, vlera të gjuhës, të traditës, të jetës në komunitet për të cilat pak ose aspak është shkruar në punime ose rreferime shkencore. Për të gjitha këto, ky punim kërkimor paraqet edhe një thirrje për institucionet e trashëgimive kulturore, arkeologjike, vendore e qëndrore me qëllim identifikimin dhe dokumentimin e vlerave që mbart komuniteti polenak.

Fjalë kyçe: historike, kulturore, përsiatje, Polena, tradita.

HISTORICAL AND CULTURAL APPROACH OF POLENA VILLAGE

Abstract: Polena is one of the earliest settlements in the Korça area, with archeological traces, traditions and early customs.

The purpose of this paper is to identify the elements of history, culture, economic aspects, religion, spoken language, behavior inside and outside the Polena community, customs and traditions as well as elements of daily life.

The methodology used in this paper is a combination of previous studies and written data and field interviews conducted with residents of the area. The

interviewing technique in this study serves as a tool to identify the elements that are the purpose of the study.

Through the data collected through the preliminary documents, the interviews conducted directly clarify that in the history of Polena there are a number of events that need to be written and further researched, starting from the fact that Polena represents an early settlement, established through archaeological finds around it. Polena, on the other hand, represents a community with cultural and linguistic values, tradition, community life, which little or nothing has been written in scientific works or references. For all the above, this research paper is a call for cultural, archaeological, local and central heritage institutions in order to identify and document the values carried by the Polena community.

Key words: *historical, cultural, research, Polena, tradition.*

HYRJE

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2056), Polena përcaktohet si një nga fshatrat e Korçës, pjesë e ish-komunës së Voskop (sot, njësia administrative Voskop, Bashkia Korçë), e cila shtrihet në perëndim të qytetit të Korçës, 860-900m lartësi mbi nivelin e detit. Polena kufizohet në lindje me Dvoranin dhe Qatromin, në perëndim me Lavdarin, në veri me Zaradishtin dhe Voskopin, në jug me Dërsinkun (Papa Kostandin Tollkuçi 1927, f. 2). Theksohet se në Polenë gjenden gjurmët arkeologjike të një vendbanimi ilir të shek. VIII-VII p.e.r. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2056). Gjatë sundimit osman Polena u zhvendos dy herë më në perëndim.

Gjatë Luftës ANÇ u dogj nga pushtuesit e vendit dhe përsëri u rindërtua në truallin e mëparshëm. Këshilli NÇ u ngrit në tetor 1942. Celula e Partisë u formua më 30.6.1942. Më 1-3 mars 1943 u mbajt Konferenca e qarkut të PKSH për Korçën. Rreth Polenës janë bërë mjaft përpjekje midis forcave partizane dhe pushtuesve. Polena është qendër e kooperativës së bashkuar. (Fjalorin Enciklopedik Shqiptar 1985).

Tokat e fshtati prodhojnë misër, elb, tërshërë, urov, thekër, fasule, qiqra, thjerrëza dhe rrush të shkëlqyer (ibidem). Veprimtarinë kryesore ekonomike kishin kultivimin e grurit, panxharsheqerit, rritjes së gjedhëve dhe dhenëve. Pranë fshatit gjenden shtresa gëlqerorësh të mermerizuar, me vlerë të veçantë për ndërtime. Mjeshtërit polenakë janë shquar për punimet në gur. Popullsia përllogaritet në 678 banorë në vitin 2005, ndaj 610 banorëve në vitin 1926. Popullsia e fshatit ka

emigruar vazhdimisht brenda e sidomos jashtë vendit (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 2057).

Përmes dokumentave të shkruara (pak të gjendshme), hulumtimit paraprak dhe intervistave të kryera më banorët e Polenës (përmes të cilave janë mbledhur të dhënat parësore) evidentohen materiale të shumta por pak të strukturuar të një vendbanimi të hershëm, me të dhëna të shumta historike e kulturore, të veprimtarisë ekonomike, zakoneve e traditave dhe jetës së përditshme të një prej zonave që ka kontribuar si për zhvillimin e zonës ashtu edhe për zhvillimin e qytetit të Korçës. Nisur nga të dhënat e grumbulluara në vijim të këtij punimi do të evidentohen aspekte të tilla, si:

- Ngjarjet që shënjuan historinë e Polenës.
- Vështrim mbi aspektet kulturore dhe traditës.
- Vështrim mbi aspekte të veçanta, të gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak.

Materialet e paraqitura nuk janë shteruese, në kuptimin e plotë, por janë një përpjekje për të strukturuar informacionet e mbledhura përmes dokumentave dhe rrëfimeve të disa dhjetra burimeve përgjatë periudhës janar-prill 2022.

QËLLIMI DHE METODA E STUDIMIT

Kjo përsiatje historike u nis me një referencë shkencore për të treguar disa karakteristika të besueshme e të vërtetueshme për lexuesit. Ky punim ka në bosht të tij fshatin Polenë duke dëshmuar përmes rrëfimeve aspekte historike, tradita, doke e zakone të njërit prej fshatrave më të rëndësishëm në zonën e Korçës. Qëllimi i këtij punimi është përshkrimi i elementëve historike, kulturore, ekonomike, fetare, gjuhës së folur, sjelljes brenda dhe jashtë komunitetit polenak, zakoneve e traditave si dhe elementëve të jetës së përditshme.

Të gjitha sa më sipër, do të realizohen bazuar në dorëshkrimet e mbledhura, të dhënat e shkruara, si dhe në bazë të teknikës së intervistimit (Azemi & Bujari 2013, f. 32) të marra nga banorët e zonës, në terren. Të dhënat parësore në këtë punim do të prezantohen përmes intervistave të kryera në terren me banorë të komunitetit polenak. *“Intervista është një mjet mjaft efikas për mbledhjen e të dhënave në këtë studim. Kërkues të ndryshëm kanë përcaktuar formate të ndryshme duke përfshirë këtu intervista etnografike, intervista të thelluara e kështu me rradhë”* (Le Compte & Preissle, f. 58). Matthews dhe Ross

(2012, f. 219) theksojnë se intervista është një metodë e mbledhjes së të dhënave që zakonisht:

- Lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë midis dy njerëzve, ose ballë për ballë, osë në distancë nëpërmjet telefonit ose internetit.
- I lejon intervistuesit të marrë informacion, ndjenja dhe opinione nga i intervistuari duke përdorur pyetje dhe dialog ndërveprues.

Modeli i intervistës së përzgjedhur është modeli i intervistës gjysmë të strukturuar. Autorët (Ivi, f.220) theksojnë se *“njihen disa struktura të ndryshme të intervistave, të cilat variojnë nga intervistat gjysmë të strukturuar në intervistat e pastrukturuar”*. Në një intervistë gjysmë të strukturuar, kërkuesit zakonisht përgatisin të njëjtin grup pyetjesh për çdo intervistë por i lejojnë vetes dhe pjesëmarrësve mundësinë për të dalë jashtë protokollit” (Lodico et al 2006, f.124). Për këtë arsye, që në krye të herës përmes të dhënave të grumbulluara nga hulumtimi paraprak është hartuar një intervistë me një bosht pyetjesh, por përgjatë intervistave pjesëmarrësve i'u është lejuar mundësia për të diskutuar dhe për çështjeve të tjera. Intervistat e kryera me banorët e zonës së Polenës janë rregjistruar me zë (duke marrë dakortësinë e tyre) me qëllim e vetëm që të mbrohet integriteti i të dhënave. Përzgjedhja e banorëve të intervistuar është bërë bazuar në:

- Klasifikimin bazuar në moshat e ndryshme të individëve të intervistuar.
- Klasifikimin bazuar në njohuritë paraprake mbi zonën e Polenës.
- Klasifikimin bazuar mbi rolin personal e profesional që kanë patur e kanë në fshatin e Polenës.

NGJARJET QË SHËNJUAN HISTORINË E POLENËS

Polena është një krahinë që dëshmon për një vendbanim të hershëm, ashtu si përcaktohet në Fjalorin Enciklopedik të Shqipërisë, dorëshkrimin të Papa Kostandini Tollkuçit (tani e tutje, Papa Sotiri) dhe intervistave të kryera me banorët e zonës (A. K., K. Sh., N. T., P.C, V.V.). Të dhënat historike shkencore mungojnë për disa arsye si: kërkimet e pakta të arkeologëve, studimet e mungura në drejtim të shkrimit të historisë për këtë zonë dhe rrëfimeve të pakta të shkruara,

të cilat më shumë se objekt studimesh janë përpjekje për të mbajtur gjallë historinë e Polenës dhe figurave të shquara polenake.

Në rrëfimet e Papa Sotirit (Historia e fshtatit Polenë 1927 f.4) theksohet se për historinë e hershme të Polenës nuk ka ndonjë dokument të shkruar por rrëfimet e banorëve janë të përafërta dhe përfundimet që dalin përmes tyre ofrojnë të njëjtën qasje mbi historinë e zonës. Këtë qëndrim e gjejmë edhe në intervistat me banorët e zonës si Petro Theodhor (Todi) Cinako⁶ i cili shprehet se “*Polena është një vend me histori të shumtë por të pashkruar, informacionet janë trashëguar përmes rrëfimeve të më të vjetërve në brezat e rinj*” (intervistë personale, 10 mars 2022) apo Andrea Koroveshi⁷ i cili shprehet se “*Polena është një vendbanim që daton prej shek. VI p.e.r, gjetjet arkeologjike e dëshmojnë këtë, materialet historike të shkruara janë të cunguara*” (intervistë personale 22 mars 2022). Sa i takon gjetjeve arkeologjike banorët (ibidem) shprehen se në zonë janë bërë kërkime të cilat kanë zbuluar heshta, armë dhe stoli të cilat janë zhvendosur në qytetin e Tiranës. Në kujtimet e Petro Ciankos, Vasil Velos⁸ dhe Andrea Koroveshit në vitin 1983 janë kryer kërkime të tjera arkeologjike në pjesën e Zaradishtit. Mozaiku i Polenës (Damko 1988, f. 226) është zbuluar përmes gërmimeve në vitin 1986. Autori (Ivi, f.227-232) përshkruan me detaje procesin e identifikimit, sondazheve paraprake, gjetjet arkeologjike, strukturën e mozaikut, si dhe kompozimin e tij. Përfundimet e gjetjeve të mozaikut dëshmojnë për një vendbanim të hershëm. Ky përfundim përforcohet dhe në studimin e autorit për zhvillimin e vendbanimit antik e bazilikës së Zaradishtës (Damko 1993, f. 259-271). Të dhënat arkeologjike të gjetura në zonë dëshmojnë për një vendbanim më një zhvillim të dukshëm që në kohën e antikitetit.

Zhvendosjen më të madhe të popullsisë, thënë ndryshe shpërnguljen më të madhe Polena e ka patur rreth viteve 1400, që lidhet me pushtimin Osman në Shqipëri (A. Koroveshi, intervistë personale, mars 2022). Një pjesë e popullsisë u detyrua të emigrojë drejt Greqisë dhe

⁶ **Petro Theodhor (Todi) Cinako**, i datëlindjes qeshor 1930, sot 92 vjet, një nga banorët më të vjetër në fshatin Polenë.

⁷ **Andrea (Theodhor) Koroveshi**, i datëlindjes 19 korrik 1970, një nga pasardhësit e fisit Koroveshi.

⁸ **Vasil (Naum) Velo**, i datëlindjes 9 gusht 1963, pasardhës i fisit Velo, mjeshtër në punimin e gurit e sidomos gurit të kuq të Polenës.

Italisë më pak, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë u zhvendos në pjesën e sipërme të Polenës së sotme, e cila njihet si Polena e Sipërme. Në Polenën e Sipërme rreth viteve 1400-1700 u krijua një strukturë bashkëjetese, ngjashëm me modelin e Voskopojës ku kishte zejtarë, tregëtarë, përpunues të gurit, poçerisë etj. Në aspektin administrativ Polena e Sipërme ishte në varësinë e Voskopojës ndërkohë që kisha ishte e varur nga Kisha e Shën Prodhomit me një status të veçantë (ibidem). Familjet më të njohura të zonës ishin: Zguro, Koroveshi, Tollkuçi, Cianko, Manço, Gogoli, Tanço e Shore (Cianko, intervistë personale, mars 2022).

Një fakt i rëndësishëm historik për Polenën e Sipërme është vrasja e të dërguarit të Ali Pashë Tepelenës. Ngjarja lidhet me fuqizimin, zgjerimit dhe ushtrimin e kontrollit të Ali Pashës Tepelenës gjatë sundimit të tij. Qëllimi i të dërguarit të Ali Pashës, komandant Mersin (Isuf) Arapit ishte së pari, kthimi i popullsisë nga orthodhokse në muslimane dhe së dyti, marrja e sa më shumë burrave dhe djemve të zonës si ustallarë për ndërtimin e kalave të Ali Pashë Tepelenës. Rezistenca e banorëve çoi në vrasjen e komandatit Mersin Arapi, varrosjen e tij në vendin e vrasjes dhe vendosjen e një guri i cili identifikohet edhe sot (intervistat me Petro Cianko, Andrea Koroveshin, Nuçi Tomço⁹ dhe Kristaq Shore¹⁰). Për shkak të këtij konflikti, këshilli i fshatit kërkoi ndihmë për mbrojtje në familjen e Frashërinjve, të cilët si këmbim për shërbimet e tyre do të merrnin një pagesë (ibidem). Në kujtimet e Papa Sotirit theksohet: *“fshati i’u paguante atyre 1500 grosh dhe ushqime për dy vetë, një për Qehajanë dhe një për ndihmësin e tij, si edhe lëndë djegse. Vendbanimi për dy njerëzit e Beut u lëshuan përkohësisht banesat e fshatit, por më vonë u ndërtuan me themeli kulla, në një vend të tillë që nga lart të vrojtoheshin të gjitha shtëpitë dhe rrugët e fshatit”* (Historia e fshatit Polenë 1927 f.4). Me kalimin e kohës të dërguarit e familjes Frashërlliu u zhvendosen totalisht në fshat duke kontrolluar gjithë veprimtarinë e banorëve. Kjo situatë nxiti pakënaqësi tek banorët, të cilët të gjendur përballë mungesës së drejtësisë u larguan drejt Ohrit, Megarovës dhe Krushovës të Manastirit, ndërsa pjesa e popullsisë së mbetur u pajtua

⁹ *Nuçi (Sotir) Tomço*, i datëlindjes 20 tetor 1942, me profesion inxhinier mekanik, pasardhës i familjes Tomço.

¹⁰ *Kristaq (Stavre) Shore*, i datëlindjes 8 dhjetor 1944, me profesion inxhinier pyjesh, pasardhës i familjes Shore.

me politikën e ndjekur nga të dërgurit e Frashëllinjve. Kjo shënon zhvendosjen e dytë të madhe të popullsisë polenake ku prej rreth 300 familjesh, në fshat mbetën 25-20 familje. Këtë situatë bejlerët e shfrytëzuan që të bëheshin “zyrtarisht” pronarë të tokave të Polenës (ivi. f. 5-6). Mirpo, të gjendur në kushtet e pamundësisë për punimin e tokave bejlerët ranë dakort që popullsia polenake të kthehej në territoret e veta duke ndjekur një politike bashkëpunuese. Kjo ngjarje ka ndodhur rreth viteve 1840. Edhe pas kthimit të një pjese të madhe të popullsisë gjendja në fshat nuk pati ndryshime të theksuara. Banorët vazhdonin të ishin të shtypur e të shfrytëzuar nga bejlerët. Për këtë arsye, këshilli i fshatit me qëllim kthimin e tokave në familjet polenake i hodhi në gjyq bejlerët (sipas juridiksionit të kohës çështja duhet të trajtohej nga gjykata e Korçës). Gjykata e Korçës në viti 1876 vendosi në favor të bejlerëve për shkak të ndikimit që kishin ata në administratën e kohës (intervistat me banorët). Për këtë arsye, u caktuan tre përfaqësues, të cilët e ndoqën çështjen deri në gjykatën e Manastirit. Në kujtimet e Papa Sotirit përfaqësuesit ishin: Nikolla Duro, Vangjel Kacidhja dhe Thimjo Petre Zguro (Historia e fshatit Polenë 1927, f.8). Në gjykatën e Manastirit u anulua vendimi i Gjykatës së Korçës dhe pronat do t’i ktheheshin polenakëve. Kjo ngjalli pakënaqësi tek bejlerët të cilët këtë çështje pretenduan ta dërgonin deri në Stamboll. Sipas dokumentave të kohës të Stambollit bejlerëve i’u njohën vetëm 472 dynym arë, livadh dhe vreshta. Ekzekutimin e dokumentave dhe urdhërave të gjykatave e kreu Kadiu i Korçës. Për largimin tërësor të bejlerëve nga tokat e tyre banorët e Polenës mblodhën para në çdo shtëpi dhe i’a dorëzuan bejlerëve duke e riblerë Polenën. Pas largimit përfundimtar të bejlerëve jeta në komunitet paraqitej e qetë, e mirë ekonomikisht, festoheshin festat fetare dhe pagane, si edhe u ruajt lidhja e fortë mes banorëve të zonës, duke dëshmuar për një komunitet homogjen (historia e fshatit Polenë 1927 & intervistat me banorët e zonës).

Nga pavarësia e Shqipërisë deri në periudhën e Mbretit Zog dallohen disa ndryshime të lehta në jetën e banorëve. E veçanta e kësaj periudhe ishte regjistrimi për herë të parë e popullsisë ku sipas të dhënave rezultoi me 130 shtëpi dhe 600 banorë (intervista personale N. Tomço & K. Shore, mars 2022). Pati disa zhvillime të profesioneve të kohës si: zejtarët, këpucarët, samarxhinjtë, gurëgëdhendësit, etj. Puna dhe shkëmbimet tregëtare të kohës ishin të përqëndruara kryesisht në qytetin e Korçës (ibidem).

Përgjatë Luftës Nacional-Çlirimtare polenakët u dalluan për një angazhim të qënësishëm si në mbështetjen e luftës me burime financiare ashtu edhe me trupa partizane. Ky angazhim pati edhe një numër të madh dëshmorësh. Ngjarje e errët për historinë e Polenës është djegia nga forcat e Ballit Kombëtar në vitin 1943. Rindërtimi i shtëpive të djegura u realizua nga popullsia vendase dhe nga mbështetja me të ardhura nga shoqata e polenakëve të Amerikës. Mbështetja që fshati dha për luftën Nacional-Çlirimtare u reflektua përgjatë kohës së komunizimit ku Polena shumë vonë pranoi të kthehej në kooperative bujqësore, duke mos patur asnjë penalitet për pranimin me vonesë të sistemit ekonomik të aplikuar përgjatë regjimit komunist (intervista personale N. Tomço & K. Shore, mars 2022).

VËSHTRIM MBI ASPEKTET KULTURORE DHE TRADITËS

Polena është një zonë e cila në kohë ka ditur të dëshmojë kulturën, traditat, zakonet, organizimet festive, ritualet, si dhe të ndikojë përmes njerëzve të shquar në jetën shoqërore, ekonomike, politike të zonës por edhe më tej. Në këtë pjesë të punimit do të prezantohen katër elementë të kulturës dhe traditës polenake: karnavalet, festat fetare, muzika dhe arsimit.

• Karnavalet

Karnavalet janë një nga festat tradicionale të zonës të Korçës në përgjithësi por edhe të zonës së Polenës në veçanti, që në fakt kjo festë në zonë njihet si festa e “Arapëve”. Festa e “Arapëve” ose e njohur ndryshe si festa e “Rrogeçëve” është një festë pagane, e cila zhvillohet gjithmonë pas Krishtlindjeve. Në studimin e saj, Sela (2019, f.152) thekson se: *“Ky rit është kremtuar gjërësisht ndër fshatrat me banorë të krishterë dhe kryesisht fshatra me pakica kombëtare arumune... Në fakt, organizimi i këtij rriti është i ngjashëm me Karnavalet në Bullgari, por edhe në Greqi”*. I njëjti fakt është dëshmuar edhe nga bisedat e kryera me banorë të zonës, të cilët flasin për një origjinë të hershme të zhvillimit të kësaj feste pagane e ndikuar dhe nga lëvizjet e popullsisë drejt zonave migratore e më tej rikthimit në Polenë. Festa e “Arapëve” përkon me një festë tjetër shumë të rëndësishme e që festohet rregullisht nga banorët e zonës, festën e “Ujit të Bekuar”. Si rregull, “festa e arapëve” zhvillohet gjithmonë pas ceremonisë kishtare (meshës) të “Ujit të Bekuar”. Madje aq shumë janë munduar ta ndërthurin ceremoninë fetare me festën pagane, saqë “Arapët” në

përfundim të meshës shkojnë ashtu të maskuar (me veshjet karakteristike) dhe i “vjedhin” bukët rituale priftit (Ivi, f.154).

- **Festat fetare**

Duke qënë që popullsia e Polenës i përket besimit orthodhoks festat fetare kryhen në mënyrë të rregullt nga banorët vendas. Në rend kronologjik disa nga festat më të rëndësishme janë: në datën 1 janar festohet “Shën Vasili i Madh”, në datën 6 janar festohet “Uji i Bekuar” dhe festa e “Arapëve”, në datën 17 janar festohet “Shën Andoni”, në 18 janar festohet “Shën Thanasi”, në prill festohen “Pashkët”, në 9 maj festohet “Shën Kristofori”, në qeshor festohet “Shën Prodhomi”, në datën 25 dhjetor “Krishtlindjet”. Këto festa janë një manifestim jo vetëm fetar por edhe i lidhjes së ngushtë që ka komuniteti polenak me njëri-tjetrin. Festat fetare janë zhvilluar edhe përgjatë periudhës së komunizmit kur ishin të ndaluara me ligj (intervista personale N. Tomço, mars 2022). Festat e tilla si “pashkët” dhe “lyerja e vezëve me ngjyrën e kuqe” janë zhvilluar pavarësisht kohës dhe mundësive. Traditën e festave të tilla nuk e ndaloi as ligji i atëherëshëm i cili zvendësoi festat fetare me festa të ideologjisë komuniste (Qazimi 2012, f.12). Lidhja e fortë me festat fetare dhe përkatësinë orthodhokëse të komunitetit polenak lidhet edhe me faktin që pavarësisht prishjes së kishave të fshatit, kremtimet e festave fetare janë ruajtur në kohë si dhe duke u trashëguar brez pas brezi (intervista personale N. Tomço, mars 2022). Në kujtimet e Papa Sotirit (Historia e fshatit Polenë 1927 f.3) theksohet se: *“çdo familje, çdo vit përkujton një shenjtor dhe presin vizita nga miqtë dhe të afërmit e tyre...luten për shëndetin e tyre, familjeve të tyre, të afërmeve, bashkëfshatarëve brenda dhe jashtë vendlindjes”*. Kjo ngjarje dëshmon për lidhjen e fortë mes komunitetit polenak dhe përkatësinë e ngushtë me festat fetare.

- **Muzika**

Këngët polenake, serenatat e Polenës janë nga më të njohurat në zonën e Korçës. Serenatat e kënduara në Polenë janë sjellë kryesisht rreth viteve 1900 nga emigrantët polenakë në Greqi. Tekstet janë gërshetime këngësh të përkthyer nga greqishtja dhe sllavishtja. Më tej, tekstet e këngëve janë përshtatur, ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi (intervista personale K. Shore, mars 2022). Këngët e vjetra polenake janë formësuar nga dy intelektualë polenakë si Sotir Koroveshi dhe Rafail Minka (intervista personale A. Koroveshi, mars 2022).

Fillimisht serenatat polenake janë kënduar edhe në Korçë, por më së shumti ato janë zhvilluar e përshtatur në Polenë. Krahas këngëvë në fshat ka patur edhe një grup që njihej si “grupi i teatrit”, i angazhuar kryesisht në përgatitjen e pjesëve teatrale të cilat luheshin në “shkollën e fshtatit”. Shpesh këto pjesë teatrale shoqëroheshin edhe me muzike, kënge e serenata polenake dhe me vegla muzikore. Vegla muzikorë që më shumti gjendej në atë kohë ishte mandolina. Tradita muzikore e Polenës është ruajtur edhe në ditët e sotme. Grupi i Polenës është një nga më të njohurit në zonë. Ndërkohë që tradita e këngës është trasmetuar dhe në brezat më të rinj (intervista personale N. Tomço, mars 2022).

- **Arsimi**

Zona e Polenës dallohet si një nga zonat më arsimdashëse në qarkun e Korçës. Kjo lidhet më së tepërmi me ndërtimin e shkollës së parë në fshat që në fund të viteve 1890. Ndikim të theksuar në arsimin kanë luajtur dhe klerikët që kanë shërbyer në kishat e zonës përmes mësimit të gjuhës greke për banorët vendas. Pandi Cianko në kujtimet e tij shprehet se: *“geqishten e kam mësuar që në klasë të tretë, mësuesit e tjerë të shkollave ishin kryesisht nga fshati por kishte edhe nga vende të tjera. Edhe babai im e ka bërë shkollën në Greqi”* (intervista personale P. Cianko, mars 2022). Shkolla shqipe në fshat ka patur që në vitin 1887. Dedja et al (2003, f.16) thekson se: *“...dy javë më vonë u çel shkolla shqipe në Pogradec, pastaj me radhë në Ohër, Rekë, Ersekë, Leskovik, Polenë, Luaras, Elbasan”*. Për ndërtimin e shkollave në fshat ka kontribuar edhe shoqata e polenakëve. Shkolla e vajzave ka qënë e ndërtuar me gurë madhorë të kuq, e organizuar me dy kate. Në hyrje të shkollës ishte vendosur edhe një gur ku shkruhej “shoqëria djalëria polenare” (intervista personale N. Tomço & K. Shore, mars 2022). Ndikimi që luajti arsimi në zonën e Polenës i solli rajonit të Korçës në veçanti por dhe Shqipërisë në përgjithësi një numër të madh intelektualësh të cilët kanë kontribuar në fusha të ndryshme të shoqërisë si në mjekësi, aviacion, arsim, sport, ekonomi, teatër, muzikë etj. (ibidem).

VËSHTRIM MBI ASPEKTE TË VEÇANTA, TË GJUHËS SË FOLUR, SJELLJES BRENDA DHE JASHTË KOMUNITETIT POLENAK

- **Aspekte të veçanta**

Martesat kanë qënë një nga elementët dallues dhe të veçantë të komunitetit polenak. Përgjithësisht martesat janë kryer sipas riteve dhe praktikave të besimit orthodhoks. Në disa raste, martesat kryheshin brenda fshatit me qëllim përforcimin e marrëdhënieve mes komunitetit. Pjesa tjetër e martesat janë kryer në zona që popullsia i përkiste besimit orthodhoks siç ishin: Shipska, Gjançi, Vithkuqi, Bellovoda, Rëmbeci, Çifligu. Martesat brenda të njëjtin besim fetar kanë qënë traditë dhe një rit i aplikuar deri vonë (intervistat me banorët e zonës).

Në aspektin ekonomik gjuetia është një traditë e zonës e cila është zhvilluar si për mjet jetese. Më vonë, gjuetia u pa dhe si sport. (intervista personale N. Tomço & A. Koroveshi, mars 2022). Mjetet e përdorura për gjueti kanë qënë “çarqet” dhe “leqet” në fillesat e më vonë janë përdorur armët e zjarrit. Si sport, armët e gjahut janë përdor në garat me piatël, ku nga zona e Polenës ka patur pjesëmarrës në nivel kombëtar e ballkanik në këto gara (ibidem).

Në prodhimtari, krahas kulturave bujqësore të zonës së Korçës, Polena është e dalluar për kultivimin e varieteteve autoktone të rrushit të zonës. Zona e Polenës ka traditë të hershme në kultivimin e vreshtave dhe prodhimin artizanal të verës dhe rakisë (intervistat me banorët e zonës). Gurëgëdhendja është një nga elementët që e bën të veçantë zonën e Polenës. Më së shumti, gurëgëdhendja lidhet me familjen e Vasil Velo dhe Kristaq Papargjirit. Këtë traditë këto familje e kanë trashëguar përmes pasardhësve të tyre dhe dhjetra punimeve në gur të cilat gjenden edhe sot. Gurëgëdhendësit polenakë dallohen më së shumti për përpunimin e gurit të kuq i cili gjendet në këtë zonë. Disa nga veprat të cilat gjenden edhe sot në qytetin e Korçës janë: “Ikona në kishën e Shën Gjergjit” e punuar në vitin 1885, “çezma në fshatin e vjetër e njohur me emrin kashen” e punuar në vitin 1877, “këmbanarja e kishës së Shën Thanasit e punuar në vitin 1906, “shatërvani në Lëndina e Lotëve në qytetin e Korçës”, “shkronja A në vepra e ABC-së e Mësenjtores së parë Shqipe”, si dhe punime të tjera në banesat e vjetra tipike korçare (intervista personale V. Velo, mars 2022).

- **Gjuha e folur**

Gjuha e folur në zonën e Polenës është gjuha kombëtare, gjuha shqipe. E veçanta e këtij komuniteti lidhet me përdorimin dhe të folurit edhe të gjuhës greke. Gjuha greke lidhet së pari me përdorimin e saj në liturgjinë dhe në kremtimet festive në kishë. Petro Cianko (intervistë personale, mars 2022) thekson se: *“gjuhën greke e kam nisur që në klasën e tretë nga Pandi Minka. Pandi Minka kryente seminarin për prift dhe në këtë mënyrë ja u mësoi edhe fëmijëvë të fshatit në Polenë”*. Një aspekt tjetër përmes së cilit u mësua gjuha greke ishin levizjet migruese dhe afërsia gjeografike me Greqinë. Pjesa më e madhe e polenakëve kanë punuar në Greqi si ustallarë duke mësuar në mënyrë autodidakte edhe gjuhën greke. Tregëtia ishte një faktor me rëndësi që ndikoi në mësimin e gjuhës greke. Rrugët tregëtare që përdorin polenakët drejt Greqisë kanë ndikuar në mësimin e kësaj gjuhe (intervista personale V. Velo & A. Korovesi, mars 2022).

- **Emigrimi**

Krahas dy zhvendosjeve të mëdha të popullsisë (të paraqitura në sipër), drejt Greqisë e Italisë e mandej drejt Ohrit e Manastirit, të cilat ishin të detyruara, polenakët emigruan edhe drejt shteteve më të largëta si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Argjentina dhe Australia. Papa Sotiri në kujtimet e tij shkruan se i pari që emigroi drejt Amerikës ishte Ilija Kallço në maj të vitit 1904 i cili gjendej në Rumani në atë periudhë. Brenda dy viteve në SHBA emigruan rreth 70-80 polenakë të tjerë, të cilët krijuan të ashtuquajturën *“Vëllazëria mirëbërëse e fshatit Polenë”* (Historia e fshatit Polenë 1927, f. 14). Qëllimi i kësaj shoqate ishte mbledhja e të ardhurave të emigrantëve dhe investimi i tyre në Polenë me qëllim përmirësimin e jetës së banorëve që jetonin aty. Fillimisht, të ardhurat e para u përdorën për largimin e bejlerëve nga tokat e Polenës kurse pjesa tjetër u përdor për shkollën, kishën, ndërtimet, veprat publike etj.

Një pjesë tjetër e Polenakëve kanë emigruar në Greqi. Kjo zhvendosje ka të bëjë edhe me lidhjen e ngushtë që këta banorë kanë patur me kishë, mësimin e gjuhës greke, afërsinë gjeografike me Greqinë dhe rrugët e shumta tregëtare përmes të cilave polenakët zhvilluan ekonominë e tyre.

- **Komuniteti polenak**

Krijimi i shoqatës polenake *“Vëllazëria mirëbërëse e fshatit Polenë”* dëshmon për lidhjen e ngushtë dhe vetëdijësimin për mbrojtjen e

vlerave, traditës dhe kulturës të Polenës. Shoqata në krye të herës u krijua me qëllim rikthimin e territoreve polenake në banorët vendas por më vonë ajo e shtriu më tej veprimtarinë e saj duke ndërtuar vepra publike në zonë, duke ndihmuar në ndërtimin e kishave dhe shtëpive, zhvillimin e jetës në komunitet si edhe duke promovuar vlerat e këtij komuniteti kudo ku kishte emigrantë nga Polena. Lidhja e ngushtë me vlerat fetare, angazhimi i përbashkët në festat festive, mbështetja për njëri-tjetrin, ruajtja e traditave të festave pagane si karnavalet si dhe ruajtja e muzikës dhe trashëgiminë i tyre brez pas brezi dëshmon për qëndrueshmërinë, mirëkuptimin, besimin dhe lidhjet e forta që ekzistojnë mes komunitetit polenak (intervistat me banorët e zonës).

PËRFUNDIME

Polena paraqet një zonë me rëndësi të veçantë historike e kulturore. Gjurmet arkeologjike të gjetura në Polenë dhe në zonat rreth saj dëshmojnë për ekzistencën e një vendbanimi të hershëm. Mozaiku i Polenës është një dëshmi tjetër shumë e rëndësishme se në kuptimin historik zona paraqet interes të veçantë.

Historia e Polenës është e larmishme për shkak të ngjarjeve historike të ndodhura në territoret e saj. Popullsia e Polenës ka patur dy zhvendosje të mëdha në historinë e saj. E para, lidhet me pushtimin Osman, ku popullsia vendase për t'i shpëtuar rrezikut të asimilimit u vendos në atë vend që njihet si "Polena e Sipërme", kurse zhvendosja e dytë ka ndodhur përgjatë periudhës së kontrollit të territoreve polenake nga familja e Frashëllinjve. Një lëvizje që lindi si rezultat i pakënaqësisë së politikave të familjes bejlere në raport me popullsinë vendase.

Periudhë pa zhvillime të rëndësishme paraqitet ajo prej pavarësisë deri në periudhën e Mbretit Zog, ku dallohet regjistrimi i parë i popullsisë dhe zhvillimi tregëtar që merr hov me qytetin e Korçës.

Përgjatë Luftës Nacional-Çlirimtare veçohet angazhimi domethënës i polenakëve duke dëshmuar mbështetje si në aspektin financiar ashtu dhe me trupa partizane. Ngjarje në kuptimin negativ mbetet djegia e fshatit nga Balli Kombëtar në vitin 1943.

Në periudhën e sistemit komunist Polena dallohet si një nga zonat që merr mbështetje të gjërë nga sistemi i kohës, edhe pse shumë vonë banorët polenakë pranuan të bëheshin pjesë e sistemit ekonomik të aplikuar në atë kohë, kooperativës bujqësore.

Nga ana tjetër, Polena paraqet një zonë që ka dëshmuar brez pas brezi kulturën, traditat, zakonet dhe organizimet festive e të ritualeve. Banorët polenakë ruajnë një lidhje të ngushtë me besimin orthodhoks. Vlerat, traditat dhe kremtimet festive janë ruajtuar dhe përcjellë deri në ditët e sotme. Festat fetare janë të shumta e të përmuajshme. Angazhimi për organizimin dhe kremtimin e tyre janë një dëshmi e ruajtjes së festave fetare deri në ditët e sotme. Traditat dhe kremtimet fetare janë zhvilluar edhe në periudhën e sistemit komunist kur këto të fundit u ndaluan me ligj. Ndër festat më të rëndësishme pagane veçohen karnavalet dhe “festa e arapëve” ose e njohur ndryshe si “rrogeçëve”, e cila zhvillohet gjithmonë pas Krishtlindjeve. Polena dallohet për këngët me tekste karakteristike ose të njohura ndryshe si serenatat e Polenës. Kjo zonë ka një shumësi vlerash të veçanta si gjuha e foluar, martesat, gjuetia, gurëgëdhendja, prodhimi i verës dhe rakisë, si dhe lidhja e ngushtë me komunitetin polenak në emigrim. Të gjitha sa më sipër e bëjnë Polenën dhe banorët e saj një nga zonat më të veçanta për vlerat që mbart e që ka mundur t’i trashëgojë deri në ditët e sotme. Evidentimi i këtyre vlerave sidomos në formë të shkruar është domosdoshmëri në kushtet kur shumica prej fakteve historike, zakoneve, traditave dhe vlerave të zonës më së shumti janë trasmetuar gojarisht sesa janë dokumentar shkresërisht. Prej këtu lind edhe detyra e institucioneve publike që merren me ruajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore, si dhe institucioneve qëndrore e vendore për anagazhimin e tyre në identifikimin dhe dokumentin e vlerave që mbart komunitetin polenak.

BIBLIOGRAFIA

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2009). *“Fjalori Enciklopedik Shqiptar”*, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Vëllimi i tretë, Botimet Kristalina-KH, Tiranë, Shqipëri.
2. Andrea (Theodor) Korovesi, *komunikim personal, intervistë*, mars 20 2022.
3. Azemi, B. dhe Bujari R. (2013). *“Bazat e kërkimit në edukim”*, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, Kosovë.
4. Damko, P. (1988), *“Mozaiku i Polenës”*, titull origjinal: *“La mosaïque de Polenë”*, revista Iliria, vol. 18:1, fq. 226-233.
5. Damko, P. (1987), *“Bazilika e Zaradishtës”*, titull origjinal: *“La basilique de Zaradishta”*, revista Iliria, vol.23, f. 259-271.

6. Dedja, B. (2003). *“Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar”*, vëllimi I; botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë, Shqipëri.
7. Kristaq (Stavre) Shore, *komunikim personal, intervistë*, mars 27, 2022.
8. LeCompte, M. and Preissle J. (1993). *“Ethnography and Qualitative Design in Educational Research”*, Academic Press Ltd., London, UK.
9. Lodico, M. G., Spaulding D.T and Voegtler, H.V. (2006). *“Methods in Educational Research: from theory to practice”*, CA: Jossey-BASS, San Francisco, USA.
10. Matthews, B. dhe Ross, L. (2012). *“Metodat e Hulumtimit-Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane”*, CDE, Tiranë, Shqipëri.
11. Nuçi (Sotir) Tomço, *komunikim personal, intervistë*, mars 26, 2022.
12. Papa Sotir (Papa Kostandini Tollkuçi). (1927), *“Historia e Fshatit Polenë”*, përkthyer nga Eleni Minella Tollkuçi, dorëshkrim.
13. Petro (Theodor) Cianko, *komunikim personal, intervistë*, mars 10, 2022.
14. Sela, J. (2019). *“Rite motmoti në Korçë dhe rrethina”*, punim doktore, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Shqipëri.
15. Qazimi A. (2012) *“Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm”*, Tiranë.
16. Vasil (Naum) Velo, *komunikim personal, intervistë*, mars 22, 2022.